

Akses Info Drejtësi

RAPORT VLERËSIM

PËR

LEGJISLACIONIN DHE PRAKTIKËN PËR AKSESIN NË DOKUMENTET ZYRTARE TË INSTITUCIONEVE TË REJA TË DREJTËSISË KLGJ-së DHE KLP-së

Mars 2020

Autor: Viktor GUMI

Raport i formuluar në kuadër të Projektit Akses Info Drejtësi, projekt i Organizatës AIS me mbështetje nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Hyrje e shkurtër

Duke pasur parasysh rëndësinë e sistemit gjyqësor në aspektin politik dhe institucional, transparencja dhe qasja e tij në reformat e informacionit merr një rëndësi të dorës së parë. Adoptimi nga organet qeverisëse të gjyqësorit të parimeve dhe detyrimeve ligjore për transparencë, mund të ketë një efekt pozitiv në aftësinë e tyre institucionale, duke rritur legjitimitetin e tyre, autoritetin e tyre kundrejt aktorëve të tjerë politikë dhe në marrëdhëniet e tyre me qytetarët.

Paraqitja e një informacioni të plotë i ndihmon qytetarët të njihen me performancën e vërtetë të gjykatave dhe gjyqtarëve, dhe në të njëjtën kohë të krijojnë mundësi për trupën akademike dhe organizmat joqeveritar që të analizojnë sfidat dhe të formulojnë propozime për reforma institucionet gjyqësore.

Nga ana tjetër, aksesimi i plotë në informacion dhe reformat e transparencës janë gjithashtu të rëndësishme pasi ato kontribuojnë në funksionimin e përmirësuar të pushtetit gjyqësor dhe në këtë mënyrë nxisin qeverisjen gjithëpërfshirëse. Për shembull, roli i Gjyqësorit në luftën kundër korrupsionit e pozicionon atë si një lojtar kryesor që mund të ndihmojë në përmirësimin e përdorimit të burimeve publike dhe cilësinë e politikave publike, dhe të ndikojë në mënyrën se si qytetarët perceptojnë institucionet e tyre qeverisëse ekzekutive. Në të njëjtën kohë, në vendet në zhvillim, gjykatësit po ndërhyjnë me një frekuencë në rritje për të rregulluar ose zbutur dështimet e organeve të pushtetit ekzekutiv duke përmirësuar aksesin ndaj shëndetit, arsimit, shërbimeve publike dhe të drejtave të strehimit për grupet e cenushme. Një gjyqësor me një legjitimitet më të madh do të pozicionohet më mirë për të ndërhyrë në këto çështje.

Duhet të merret në konsideratë gjithashtu se Gjyqësori është një aktor kryesor për konsolidimin e Sundimit të Ligjit. Rëndësia e rolit të tij reflektohet në indekse dhe metodologji të ndryshme të hartuara për të vlerësuar cilësinë e institucioneve publike. Duket se në Shqipëri ekziston një ndarje e rëndësishme midis shoqërisë dhe drejtësisë, e cila, midis arsyeve të tjera, shpjegohet me kulturën e fshehtësisë dhe operativitetit që ka karakterizuar degën gjyqësore, mungesën e njohurive të popullatës në lidhje me funksionimin dhe administrimin e drejtësisë, si dhe një ndërhyrje e theksuar nga aktorët politike në punën e gjyqtarëve. Si rezultat, qytetarët kanë një mosbesim në rritje në lidhje me punën e gjyqësorit.

Informacioni që qytetarët marrin për punën e gjykatave dhe organeve të sistemit të drejtësisë vuan nga një deficit i dyfishtë: i cilësisë së dobët dhe — në disa raste — kompleksiteti i lartë. Kjo situatë, e cila kontribuon në konsolidimin e hendekut ekzistues midis institucioneve gjyqësore dhe shoqërisë, është shkaktuar nga dy faktorë kryesorë. Nga njëra anë, ekziston një deficit i rëndë në media për sa i përket aftësisë së tyre për të raportuar se çfarë po ndodh në sistemin gjyqësor dhe organet qeverisëse të tij. Në shumë raste, gazetarëve u mungon trajnim adekuat për të mbuluar veprimtarinë e gjykatave dhe për t'i shpjeguar publikut çështjet juridike që ato adresojnë në një mënyrë të kuptueshme dhe të thjeshtë. Nga ana tjetër, gjykatat apo organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë bëjnë shumë pak përpjekje për të komunikuar çështjet që ato zgjidhin në një mënyrë të përshtatshme.

Përballë kësaj diagnoze, AIS ka ndërmarrë dhe zhvilluar këtë projekt për të adresuar problemin. Edhe nën këtë kontekst, zbatimi i transparencës dhe qasjes në reformat e informacionit nga KLGJ dhe KLP përpiqet të kontribuojë në kthimin e mungesës së besimit të përgjithësuar në institucionet gjyqësore, duke promovuar sa të jetë e mundur një afërsi më të madhe midis qytetarëve dhe sistemit të drejtësisë.

Informacion i përmbledhur për dy organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë KLGJ dhe KLP

Rimodelimi i arkitekturës së gjyqësorit në Shqipëri, i konceptuar nga një radhë e gjerë aktorësh, ishte një nga shtyllat kryesore të reformës gjithëpërfshirëse të drejtësisë në Shqipëri, e nisur që në 2014 dhe akoma në vazhdim e sipër. Qëllimi i Reformës është forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së gjyqësorit si një nga prioritetet kryesore për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Një parakusht për zbatimin e Reformës ishte miratimi i ndryshimeve kushtetuese në Korrik të 2016, të ndjekura në vazhdim nga 27 ligje.

Ndryshimet kushtetuese u ndoqën nga një paketë gjithëpërfshirëse ligjesh organike, 7 nga të cilët u konsideruan prioritare. Qeverisja e gjyqësorit u gjykua si një çështje e rëndësishme së dorës së parë dhe u rendit në paketën e parë të ligjeve të miratuara, ndër të cilët kryesorët janë ligji “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” si dhe ligji “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar respektivisht në nëntor 2016 dhe tetor 2016.

Ngritja e organeve të reja të qeverisjes së gjyqësorit, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë të cilët de jure parashikohen në Kushtetutë dhe në ligjet organike, ka filluar të marrë formë de facto që prej qershorit 2017.

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) është institucion kushtetues, përgjegjës për pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Shqipëri. KLGJ përbëhet nga 11 anëtarë, gjatë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi nga radhët e juristëve jogjyqtarë. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor i ushtrojnë funksionet me kohë të plotë.

Anëtarët gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të gjyqësorit. Anëtarët jogjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Dy anëtarë jogjyqtarë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës si dhe një anëtar nga shoqëria civile.

Mandati i anëtarit të KLGJ është 5 vjeçar, me përjashtim të ngritjes për herë të parë të Këshillit, disa nga anëtarët e të cilit kanë mandat 3 vjeçar. Anëtari i KLGJ-së mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike, ose kur është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Me ndryshimin e përbërjes dhe kompetencave të KLGJ synohet të rritet efikasiteti e këtij organi të vetëqeverisjes së gjyqësorit. Pakësimi i numrit të gjyqtarëve por duke ruajtur shumicën në Këshill, synon të vendosë balancat e duhura dhe të rrisë frymën e kolegjalitetit në vendimmarrjen e Këshillit. Përbërja e re e Këshillit synon të shmangë konfliktet e interesit dhe imunitetin ndaj fenomenit të korporatizimit, i njohur ndryshe si mbrojtja e padrejtë që mund t'i bëhet gjyqtarëve nga gjyqtarët kur

ata kryejnë shkelje disiplinore. Gjithashtu kjo përbërje synon të shmangë klientelizmin në procesin e emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve, i cili në frymën e ligjit, duhet të jetë meritokratik.

Në krahasim me KLD-në e mëparshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk kryesohet nga Presidenti, por nga njëri prej anëtarëve jogjyqtarë që do të emërohet nga vetë radhët e anëtarëve jogjyqtarë. Gjithashtu, në këtë Këshill nuk do të ketë anëtarë për shkak të detyrës si Ministri i Drejtësisë apo Kryetari i Gjykatës së Lartë. Me formulën e re, rritet konkurrenca për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit si dhe synohet t'i jepet fund ndikimeve të padrejta që mund të vijnë nga anëtarë të cilët mbajnë funksione të larta.

Kompetencat e KLGJ-së në krahasim me ato të KLD-së janë zgjeruar dhe përfshijnë pothuajse të gjitha aspektet e administrimit të gjyqësorit në zbatim të parashikimeve kushtetuese. Sipas dispozitave kushtetuese, KLGJ ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;
- b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë sipas ligjit;
- d) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- e) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;
- f) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave;
- g) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;
- h) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

KLJGJ, me ligjin e ri, i janë besuar përgjegjësi të reja, të cilat me sistemin e vjetër të drejtësisë i ka pasur Ministria e Drejtësisë. Përkatësisht, Këshilli është përgjegjës për mbajtjen e sistemit statistikor të gjyqësorit, marrëdhëniet e gjyqësorit me publikun dhe mediat, menaxhimin e administratës gjyqësore, administrimin e infrastrukturës fizike dhe të sigurisë, si dhe matjen e performancës së gjykatave.

Me synim rritjen e efikasitetit të Këshillit dhe përmbushjes së objektivave të tij, ligji parashikon organizimin e KLGJ në 4 komisione të përhershme vendimmarrëse, përkatësisht:

- a) Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;
- b) Komisioni Disiplinor;
- c) Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale;
- d) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) është institucion kushtetues, përgjegjës për pavarësinë, përgjegjshmërinë, statusin, karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë si dhe mbarëvajtjen e organit të prokurorisë. KLP është organ kolegjal, i konceptuar me rregulla dhe kompetenca të ngjashme me ato të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Edhe ky institucion përbehet nga 11 anëtarë me kohë të plotë, gjashtë prej të cilëve prokurorë që zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë. Përbërja e re e Këshillit synon të vendosë balancat e duhura dhe të rrisë frymën e kolegjalitetit në vendimmarrjen e tij duke synuar shmangien e konfliktit të interesit dhe korportazimit gjithashtu.

Gjashtë anëtarë të Këshillit përzgjidhen nga radhët e Prokurorëve me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata zgjidhen sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të prokurorisë nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve.

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve joprokurorë është e njëjtë me procedurën e zgjedhjes së anëtarëve jogjyqtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ata përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Dy anëtarë joprokurorë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile.

Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është 5 vjeçar, me përjashtim të ngritjes për herë të parë të Këshillit, disa nga anëtarët e të cilit kanë mandat 3 vjeçar. Anëtari i KLP-së mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike ose kur është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

KLP ka një konceptim tërësisht të ri, në ndryshim nga Këshilli i Prokurorisë së mëparshëm, i cili kishte vetëm rol këshillimor. Me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore, këtij Këshilli i janë dhënë kompetenca vendimmarrëse për emërimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve. Me krijimin dhe funksionimin e Këshillit synohet të ndahen dhe vendosen balancat në ushtrimin e kompetencave në sistemin e prokurorisë, e cila do të ndikojë në rritjen e pavarësisë së brendshme të prokurorëve dhe pavarësisë së jashtme të institucionit.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
- b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
- c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm sipas ligjit;
- d) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- e) propozon dhe administron buxhetin e tij;
- f) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;
- g) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ashtu si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor organizohet në të njëjtën mënyrë dhe drejtohet nga një anëtar joprokuror. Ligji parashikon organizimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në 4 komisione të përhershme vendimmarrëse, përkatësisht:

- a) Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;
- b) Komisioni Disiplinor;
- c) Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale;
- d) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

LEGJILACIONI

Legjislacioni që rregullon Çështje të Publikimit dhe Aksesit të Detyrueshëm në dokumenta të institucioneve dhe Individëve pjesë e sistemit të drejtësisë.

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ky ligj parashikon krijimin dhe funksionimin e Dosjes Personale dhe Regjistratit të Magjistratëve si dhe rregullat apo kategoritë e publikimit online

Neni 38 i Ligjit Dosjet personale dhe regjistri i magjistratëve parashikon:

1. Këshillat krijojnë dhe administrojnë dosjet personale dhe regjistrin e magjistratëve. Regjistri i magjistratëve është një bazë unike e të dhënave profesionale dhe personale të magjistratit.
2. Dosja personale e magjistratit duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a) emrin dhe adresën;
 - b) gjendjen civile, emrin dhe profesionin e bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve;
 - c) historinë e arsimimit;
 - c) datën e emërimit;
 - d) pjesëmarrjen në kurset e trajnimit;
 - dh) çdo të dhënë me natyrë disiplinore, penale dhe të dhënat e marra nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
 - e) rezultatet e vlerësimit të veprimtarisë;
 - ë) ecurinë e detajuar të zhvillimit të karrierës;
 - f) datën dhe shkaqet e ndërprerjes së mandatit, sipas rastit.
3. Këshillat miratojnë rregulla të hollësishme për:
 - a) formatin e regjistratit dhe të dhënat që administrohen në të;
 - b) informacion shtesë që duhet të përfshihet në dosjet personale;
 - c) mënyrën e mbajtjes së dosjes personale dhe regjistratit;
 - c) pjesët e dosjes personale dhe regjistratit që aksesohen nga publiku.
4. Këshillat mbledhin dhe përpunojnë të dhënat në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

Në Nenin 91 ky ligj parashikon rregullime mbi Qasje në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun. Në këtë kuadër, Këshilli kryen detyrat e mëposhtme:
 - a) krijojnë, zhvillojnë, dhe mirëmban një portal elektronik në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për qasjen në drejtësi, përfshirë informacion të detajuar për strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifave gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera me interes publik;
 - b) bën të mundur që secila gjykatë të ketë hapësirën e saj të veçantë në portalin në internet dhe t'i lejohet të publikojë në të të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore;
 - c) merr masa që publiku dhe palët e interesuara të informohen mbi veprimtarinë e gjykatave, si dhe për çështje të veçanta gjyqësore;
 - c) miraton dhe përditëson, pas konsultimit me këshillat e gjykatave, udhëzuesit standard të shtypit.
2. Këshilli cakton në nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun.
3. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton të paktën një gjyqtar për mediat për çdo juridiksion apeli. Në ato raste kur komunikimi me publikun nuk mund të kryhet prej tij, shërbimi kryhet nga shërbimi i shtypit i Këshillit.
4. Shkolla e Magjistraturës ofron trajnim për anëtarët e Këshillit, gjyqtarët për mediat, administratën e Këshillit dhe nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun.

5. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen bazuar në parimet e së drejtës për qasje në informacion, duke pasur parasysh mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionin dhe prezumimin e pafajësisë.

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Në nenin Nenin 7, ka parashikuar Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe konkretisht sipas paragrafëve:

1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik; b) tekstet e plotë: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë; c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës; ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit; d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime; dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit; e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara; ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme; f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit; g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik; gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji; j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato; k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh; l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

2. Autoriteti publik, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

3. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike.

Transparenca e veprimtarisë së KLGJ dhe KLP në raport me median dhe vëzhguesit

Kushtetuta e Shqipërisë garanton të drejtën e informimit dhe në nenin 23 të saj i jep të drejtë kujtdo që të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive. Transparenca konsiderohet gjithashtu parësore në praktikën më të mira ndërkombëtare, të cilat rekomandojnë seanca të hapura për procedimet disiplinore të zyrtarëve të drejtësisë, me përjashtim të rasteve kur këto subjekte kërkojnë të kundërtën.

Të krijuara në fillim të dhjetorit 2018, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor kanë ndjekur deri më tani praktika të ndryshme. KLP ka zhvilluar mbledhje të hapura për median si dhe ka publikuar regjistrimet audio të mbledhjeve plenare, ndërsa KLGJ ka zhvilluar mbledhje me dyer të mbyllura dhe ka publikuar në faqen e vet online vetëm procesverbalet e diskutimeve

Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi të mbyllë dyert për median në mbledhjen plenare të datës 21 shkurt 2019, duke ofruar prej kësaj date dhe në vijim transparencë vetëm përmes faqes së internetit. Kryetari i KLP-së, Gent Ibrahimi e argumentoi vendimin me ruajtjen e privatësisë për të dhënat e subjekteve, ndërsa shtoi se median do të lejoheshin vetëm për të marrë pamje. “I qëndrojmë fort urdhërimit kushtetues për transparencë, pasi gjithçka që thuhet në këtë mbledhje brenda 24 orëve hidhet në faqen e Këshillit. Duke pasur parasysh edhe përcaktimet e tjera ligjore për të ruajtur privatësinë e të dhënave të disa prej subjekteve, çështjet e të cilëve bëhen objekt trajtimi në mbledhjet e Këshillit, ne i balancojmë këto dy kërkesa,” tha Ibrahimi në fillim të mbledhjes plenare.¹

Ky ndryshim i veprimtarisë së KLGJ/KLP dhe vendimmarrjet përkatëse të tyre për të zhvilluar mbledhjet me dyer të mbyllura për median dhe në përgjithësi transparenca e veprimtarisë së tyre kanë qenë objekt i kritikave dhe shqetësimeve të një organizmash të shoqërisë civile që merren me monitorimin e veprimtarisë së tyre. Kështu Komiteti Shqiptar i Helsinkit në një letër zyrtare është shprehur me shqetësim për disa vendimmarrje të KLGJ-së dhe KLP-së,² të cilat kufizojnë aksesin për informim publik dhe monitorim para dhe gjatë realizimit të mbledhjeve plenare.

Po ashtu disa organizata të tjera të shoqërisë civile kanë theksuar në deklaratë publike se “*Si rrjedhim, kjo situatë pamundëson jetësimin e parimit të transparencës, krijon elementë të dyshimit në integritetin e aktivitetit të institucioneve dhe ndaj mund të cenojë besimin e publikut në rezultatet dhe ecurinë e procesit. ... Së fundmi, ne apelojmë institucionet përgjegjëse, KLGJ, KLP si dhe organet e vettingut për transparencë dhe komunikim me publikun duke iu përgjigjur interesimit të tij për ecurinë dhe proceset në drejtim të ngritjes së institucioneve të hetimit dhe gjyqësorit për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke hedhur dritë mbi ecurinë e deritanishme për të shmangur politizimin dhe ecjen me hapa të shpejtë të këtyre proceseve. Transparenca dhe komunikimi i qartë, i kobshëm dhe i shpeshtë me publikun kontribuon në një klimë besimi me të mirë dhe adreson pritshmërinë që qytetarët kanë për këtë proces.*³

Konkluzione dhe Rekomandime

¹ <https://ëëë.reporter.al/keshilli-i-larte-i-prokurorisë-mbyll-dyert-per-mediat/>

² <https://ahc.org.al/ëp-content/uploads/2019/04/Leter-e-hapur-lidhur-me-karakterin-e-mbledhjeve-te-Keshillit-te-Larte-te-Prokurorisë-KLP.pdf>

³ http://ëëë.osfa.al/sites/default/files/deklarata_ne_pdf.pdf

1. Transparenca e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë duhet të përbëjë një nga karakteristikat themelore në vijimësi të identifikimit të aktivitetit të tyre. Në fund të fundit, ngritja e organeve të reja në kuadrin e reformës në drejtësisë duhet të përcjellë në shoqërinë shqiptare edhe dallimin në këtë aspekt, veçanërisht kur i krahasojmë këto organe me ato të ngritura para miratimit të reformës në drejtësi.

2. Është e vetëkuptueshme se si organe të reja kushtetuese kanë në nevoja të mëdha dhe urgjente si për buxhete të mjaftueshme, kushte fizike dhe materiale për ushtrimin në mënyrë të plotë të detyrës dhe misionit që kanë, ashtu edhe në kuadër të nevojave për burime njerëzore brenda strukturave të tyre administrative. Gjithsesi, mungesa apo mundësitë e kufizuara nuk duhet të përbëjnë një arsye të mungesës/kufizimit të transparencës për publikun për veprimtarinë e këtyre institucioneve.

3. Rezulton qartazi se këto institucione kanë një këndvështrim tjetër ligjor në raport me organizatat e shoqërisë civile për mbajtjen e mbledhjeve të tyre me dyer të mbyllura dhe pa praninë e medias në to. Organizatat e shoqërisë civile theksojnë se mbledhjet e KLGJ-së dhe KLP-së duhet të jenë të hapura për shkak të detyrimit ligjor si organe me natyrë kolegjiale, zbatimit të parimit të transparencës në veprimtarinë e tyre dhe mosparashikimit në mënyrë specifike në ligjin organik të mbajtjes së mbledhjeve me dyer të mbyllura, siç është rasti psh i mbledhjeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Institucionet rezultojnë se kanë një mendim të ndryshëm për këtë gjë, psh KLP nëpërmjet kthim përgjigjes së saj Komitetit Shqiptar të Helsinkit të datës 28.03.2019, referon se nenet 164, 165, 166 dhe 167 të ligjit nr. 115/2016, nuk përmbajnë asnjë dispozitë referuese për Këshillin për të realizuar mbledhje të hapura. Në kuadër të transparencës, KLP informon se janë publikuar njoftimet për mbledhjet plenare si dhe brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes, në faqen zyrtare bëhet publik regjistrimi audio i seancës plenare. Gjithashtu, KLP referon se është në diskrecionin e tij vlerësimi i mënyrës së realizimit të mbledhjeve.⁴ Sa më sipër, për shkak të papajtueshmërisë së këndvështrimeve dhe mungesës së një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhe eventualisht të Gjykatës Kushtetuese rezultojnë e nevojshme përmirësimi i ligjit në fuqi nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ku të saktësohet nga Ligjvënësi në mënyrë eksplicite transparenca e mbledhjeve të KLP-së dhe të KLGJ-së në mbledhje plenare si dhe në komisionet respektive të tyre.

4. Në datën 9 korrik 2019, KLGJ-ja miratoi vendimin nr. 114 “Mbi krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe regjistrimit të gjyqtarit”. Sipas këtij vendimi Regjistri i Gjyqtarëve është një bazë unike e të dhënave profesionale dhe personale të gjyqtarëve, që plotësohet mbi bazën e dosjes personale të çdo gjyqtari. Regjistri i Gjyqtarëve mbahet në format shkresor dhe elektronik. Regjistri elektronik i gjyqtarëve pasqyron të gjitha të dhënat, sipas përmbajtjes së Regjistrimit në format shkresor. Në Regjistrin e Gjyqtarëve administrohen të dhënat e mëposhtme: emri, mbiemri; datëlindja; vendlindja; vendbanimi; arsimimi; kualifikimet dhe trajnimet; pjesëmarrja në aktivitete shkencore; përvoja profesionale; data e emërimit dhe lëvizjet brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor; vlerësimet e etikës dhe veprimtarisë profesionale; masat disiplinore.

Sipas pikës 15 të këtij vendimi: “15. Të dhënat e Regjistrimit dhe Dosjes Personale të Gjyqtarit kanë karakter konfidencial. Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore publikon në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor pjesë të dosjes personale të gjyqtarit dhe të dhëna nga

⁴ <https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2019/08/RAPORT---KRIJIMI-DHE-FUNKSIONIMI-I-ORGANEVE-TE-REJA-TE-QEVERISJES-SE-DREJTESISË.pdf>

Regjistri i Gjyqtarëve, të cilat mund të aksesohen nga publiku, si më poshtë: a) Emri, mbiemri; b) Gjykata ku ushtron funksionin; c) Arsimimi; ç) Kualifikimet) Përvoja profesionale; dh) Vlerësimet e etikës dhe veprimtarisë profesionale; e) Masa disiplinore në fuqi “vërejtje publike”.

Pika 15 e vendimit të sipërcituar të KLGJ-së e redukton numrin e të dhënave për gjyqtarin sipas nenit 38 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”. Mbetet e paqartë se pse është bërë ky reduktim në të dhënat publike që duhet të përmbajë regjistri i hapur për publikun. Psh është pakuptimte se pse nuk duhet të publikohen në faqen zyrtare të KLGJ-se edhe data e emërimit, dhe lëvizjet brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor të gjyqtarit, apo pse nga të gjithë masat disiplinore duhet të jetë publike vetëm masa disiplinore “ vërejtje publike” dhe masat e tjera disiplinore jo, apo pse nuk duhet të jenë të hapura për publikun edhe vlerësimet e bëra nga ILDKPKI-ja.

Nga ana tjetër, është e nevojshme që për këtë gjë pra të dhënat që bëhen publike të sigurohet edhe uniformiteti i publikimit të tyre, pra të jenë më një standard të njëjtë të thjeshtë dhe të kuptueshëm për të gjithë gjyqtarët.

Ligji përcakton gjithashtu se gjykatat e çdo rrethi gjyqësor duhet të kenë faqen e tyre të internetit. Ndërkohë ende vijon të mbetet e paqartë se çfarë informacioni duhet të ketë për këto gjykata. KLGJ-ja rekomandohet që të miratojë një akt të veçantë nënligjor për këtë qëllim.

5. Në faqen e internetit të KLGJ-së dhe KLP-së nuk publikohen tekstet e projektvendimeve/projekt udhëzimeve dhe projekt urdhërat, si dhe relacioneve përkatëse që do të miratohen në mbledhjet pasardhëse të tyre. Vlerësojmë në reflektim të parimit të transparencës dhe njëkohësisht edhe të përmirësimit të cilësisë së akteve nënligjore që harton dhe miraton KLGJ-ja apo KLP-ja kjo gjë është e domosdoshme. KLGJ/KLP nuk miratojnë vetëm akte individuale por veçanërisht në këtë fazë të zbatimit të reformës në drejtësi duhet të miratojë një sërë aktesh me karakter nënligjor normativ dhe për të cilat pjesëmarrja dhe kontributi i publikut, akademikëve, studiuesve apo OJF-vë është i rëndësishëm.

6. Në faqen respektive të internetit të KLGJ dhe KLP ka problematikë në lidhje me publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve. KLP ka publikuar vetëm audio të mbledhjes, ndërkohë që KLGJ publikon procesverbalet pas miratimit të tyre nga KLGJ në mbledhje si organ kolegjal. Për pasojë, për KLGJ-në procesverbalet e mbledhjeve publikohen me muaj kohë vonesë nga data e mbledhjes së zhvilluar. Për këtë gjë duhet të ketë ndryshim ligjor më qëllim që të gjendet mënyra që publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të KLGJ-së të jetë vetëm disa ditë me vonesë nga data e mbledhjes së zhvilluar të KLGJ/KLP-së. Procesverbali i mbledhjeve respektive nuk ka kuptim të bëhet publik kur ka humbur aktualiteti i temës apo çështjes që është në diskutim e vendimmarrje në KLGJ/KLP.

7. Neni 72 e vijues të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” përcakton çështjen e konfliktit të interesit për anëtarin e KLGJ”. Neni 171 e vijues rregullon ligjërisht këtë çështje për anëtarin e KLP-së. Është e paqartë sesi zbatohen këto dispozita dhe si bëhet transparenca e plotë nga ana e KLGJ/KLP për zbatimin e tyre. Një mundësi është të bëhet publike në web axhenda e mbledhjes së radhës së KLGJ/KLP-së dhe po ashtu brenda 24 orësh nga bërja publike e axhendës së mbledhjes, anëtarët e KLGJ-së të nënshkruajnë deklaratë të posaçme për çështjen e konfliktit të interesit, e cila duhet të bëhet publike menjëherë në faqen e web-it. Ndjekja e shembullit të Kuvendit⁵ vlerësojmë se përbën një praktikë të mirë që duhet të ndiqet edhe nga anëtarët e KLGJ-së dhe KLP-së në çështjet e konfliktit të interesit.

⁵ <https://ëëë.parlament.al/Files/RaporteStatistika/Anastasangjelidek2019.PDF>

8. Është e nevojshme të përmirësohen faqet e internetit të KLGJ-së dhe KLP-së. Këto faqe interneti duhet të respektojnë kërkesat e nenit 7 të ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Një kujdes i veçantë duhet t’i kushtohet si dokumentimit dhe bërjes publike të procesverbaleve të mbledhjeve dhe po ashtu edhe të vendimeve që miratohen nga këto organe. Veçanërisht në kohën kur këto institucione po miratojnë gjithnjë e më tepër vendime është e nevojshme krijimi i një database me fjalë kërkimi për tekstin e këtyre vendimeve.

Një model i mirë për zbatim nga këto organe është faqja e internetit www.parlament.al në rubrikat dokumentacioni, projektligje dhe libraria e akteve.

9. Procesverbale të një mbledhje që merr në shqyrtim kandidaturat për anëtarë të Gjykatës së Lartë sekretojnë identitetin e tyre. Në të gjithë këtë procesverbal i mohohet publikut e drejta për të njohur kandidatin për në Gjykatën e Lartë që ka aplikuar dhe nuk plotëson kriterin e “mbajtjes së gradës shkencore”. Po ashtu paraqitet e njëjta situatë edhe një vendim ilustrativ të marrë nga faqja e internetit për propozimin tek Presidenti i Republikës për emërimin e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë.

Kjo pjesë e veprimtarisë së KLGJ-së që publikohet në mënyrë të tillë është në kundërshtim me frymën e ligjit dhe transparencës së emërimin për më tepër në shkallën më të lartë të Gjyqësorit.

Përsa më sipër vlerësojmë se është e nevojshme ndërhyrja në legjislacion (neni 69, paragrafi 3 dhe neni 167, paragrafi 2 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”) dhe në aktet e tjera nënligjore për të mundësuar që veprimtaria e KLGJ-së dhe KLP-së ti shërbejë maksimalisht transparencës dhe ‘obmrella’ e ceshtjes së mbrojtjes së të dhënave personale të mos pengojë zbatimin e parimit të transparencës. Në kushtet kur KLGJ dhe KLP nuk kanë të saktësuar zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” në kuadër të veprimtarisë së tyre, mungesës së ndonjë veprimi ligjor tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit apo eventualisht në gjykatën administrative, (gjë që do të kërkojë vite) më e rekomandueshme është ndërhyrja për të amenduar ligjin për të rregulluar një situatë të tillë.

10. Rekomandojmë që përveç CV së anëtarëve që janë në përbërje të organeve të KLGJ-së dhe KLP-së të shfaqet si një rubrikë e veçantë e CV së tyre të jetë edhe deklarimi i pasurisë dhe Interesave Vetjake, të cilët ata me ligj janë të detyruar ta realizojnë. Publikimi i pasurive dhe interesave private të anëtarëve të këtyre institucioneve deri më tani është bërë vetëm nga organizatat e shoqërisë civile të cilat e marrin zyrtarisht këtë informacion nga ILDKPKI-ja në përfundim të afatit të kohor të deklarimit të tyre vjetor ose sapo anëtarë të caktuar emërohen në këtë post. Deklarimi i pasurisë dhe interesave vetjake në faqet e internetit respektive - dhe në kushtet kur ILDKPKI-ja ende nuk ka mundësuar deklarimin dhe me pas publicitetin *on line* të tyre, - do të shërbejë si një inventivë e mëtejshme vlerësimi për transparencën e veprimtarisë së tyre dhe njëkohësisht do të përbëjë edhe një dallim të dukshëm të anëtarësisë së këtyre institucioneve të krijuara nga reforma në drejtësi në raport me ato që ishin të para saj.